



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 90/2012
Prishtinë, më 15.01.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq.

Mungoi: Berat Buzhala.

Pjesëmarrës të tjerë: Ramadan Sejdiu dhe Shahe Kukaj- MZHE/ NJPMNI; Bardhyl Meta – Oda Ekonomike Gjermane /ODGJ; Haxhi Gashi-USAID/GFSI; Burim Ejupi dhe Dita Dobranja – INDEP; Besian Bicurri – KDI/TIK; dhe Naim Krasniqi – Radio Dukagjini – gazetar.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 18.12.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-176 për turizmin;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-179 për transportin rrugor;
6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-180 për investimet e huaja;
7. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit;
8. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – E njoftoi Komisionin parlamentar se ka pranuar një Rekomandim nga z. Ali Sadriu, kryetar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për të shqyrtuar së bashku të dy komisionet funksionale “Raportin për performancën e ndërmarrjeve publike për vitin 2011. Pastaj hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Visar Ymeri – Tha se Raporti i performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011, është shumë i vonuar për t’u shqyrtuar pas dy viteve. Por, theksoi se pajtohet që të këtë një organizim të përbashkët të dy komisioneve për të shqyrtuar këtë raport, sepse diskutimin e bënë shumë më substancial. Ai propozoi që në fund të diskutimit, të votojnë ndaras të dy komisionet, pasi që rekomandimet mund të dalin të ndryshme, sipas fushave që kanë të dy komisionet funksionale.

Teuta Sahatqija – Theksoi se gjatë analizës që i kam bërë Raportit të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011, ka mjaft elemente financiare që duhet sqaruar veprimet e këtyre Ndërmarrjeve Publike, se si kanë punuar e vepruar dhe sa i kanë realizuar planet dhe objektivat e NP-ve. Ajo u pajtua që të bëhet një takim me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Lutfi Zharku – Tha që në parim e përkrah kërkesën e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për të shqyrtuar së bashku këtë raport, të dy komisionet funksionale, por edhe si komisione të veçanta, të shqyrtohet, nuk ka asgjë të keqe. Mirëpo, ai shtoi se është çështje tjetër se si do t’i racionalizojmë të detajet tjera për funksionimin e ndërmarrjeve publike.

Sala Berisha-Shala – Tha se e mbështet kërkesën e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, që të këtë një takim të përbashkët, për të shqyrtuar “Raportin për performancën e ndërmarrjeve publike për vitin 2011, pasi që këtë propozim e lejon edhe Rregullorja e punës së Kuvendit.

Myzejene Selmani – Tha se, sa i përket kërkesës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, që të mbahet një mbledhje e përbashkët, mendoj që nuk është e arsyeshme për vetë faktin, që ne si Komisioni Funkcional, e mbikëqyrim fushën e politikave dhe objektivave, se sa janë realizuar nga ndërmarrjet publike, ndërsa Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, e ka për detyrë vetëm shqyrtimin e raporteve të auditorit për ndërmarrjet publike.

Hashim Deshishku – U pajtua me mendimin e znj. Selmani dhe propozoi që komisioni ta shqyrtojë një herë Raportin për performancën e ndërmarrjeve publike për vitin 2011, e pastaj mund të mbajmë edhe një mbledhje të përbashkët me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet për mbledhjen e radhës kjo pikë, për ta shqyrtuar së bashku me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike “Raportin për performancën e ndërmarrjeve publike për vitin 2011”.

Rendi i ditës u miratua, duke e hequr pikën e tretë të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 18.12.2012

Procesverbali i mbledhjes së datës 18.12.2012, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L - 176 për turizmin

Kryetari – Theksoi se sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë të projektligjeve, komisionet funksionale i shqyrtojnë në parim projektligjet. Ai kërkoi nga deputetët, që të paraqesin vërejtjet e tyre në parim apo të rezervohen që t'i paraqesin në grupet punuese.

Pas debatit, Komisionit nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr .04/L-176 për turizmin

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-176 për turizmin.

Grupi punues për shqyrtimin e këtij projektligji, ka këtë përbërje: Hashim Deshishku, raportues, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-179 për transportin rrugor

Kryetari – Theksoi se po ashtu sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë, duhet ta shqyrtojmë në parim këtë projektligj. Ai kërkoi nga deputetët që të paraqesin vërejtjet e tyre në parim apo të rezervohen që t'i paraqesin në grupet punuese.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-179 për transportin rrugor.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-179 për transportin rrugor.

Grupi punues për shqyrtimin e këtij projektligji, ka këtë përbërje: Teuta Sahatqija, raportuese, Sala Berisha – Shala dhe Visar Ymeri.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-180 për investimet e huaja

Kryetari – Theksoi se po ashtu sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë, duhet ta shqyrtojmë në parim këtë projektligj, duke kërkuar nga deputetët që të paraqesin vërejtjet e tyre në parim.

Lutfi Zharku – Tha se parimisht është joserioze nga Qeveria të sillet i njëjti projektligj, pa asnjë ndryshim, i cili nuk është miratuar në parim nga Kuvendi. Ndërsa, e dyta tha është se duhet të shikojmë edhe proceduralisht, se a është në rregull i parashtruar ky projektligj, sepse me sa di duhet të kalojnë gjashtë muaj dhe pastaj të riprocedohet projektligji, i cili nuk ka kaluar në parim. Zharku shtoi se është ligji i njëjtë ai i vitit 2004, përveç fuzionimit të agjencive dhe shfuqizimit të Ligjit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Sala Berisha – Shala- Sqaroi se Rregullorja e Kuvendit nuk ka ndonjë dispozitë që e rregullon këtë çështje. Ndërsa, sa i përket përmbajtjes dhe politikës është diçka tjetër, nëse nuk e mbështetni.

Hashim Deshishku – Tha se duhet si komision të deklarohemi në lidhje me këtë projektligj, sepse e ka kthyer një herë seanca dhe tash sjellët i njëjti dhe është mjaftë joserioze nga Qeveria, sepse është vetëm një kopje e asgjë tjetër.

Myzejene Selmani – Tha se vendimi i Kuvendit ka qenë politik, ku është kthyer, dhe tash është i riporceduar dhe Qeveria e ka këtë të drejtë. Ajo bëri thirrje që të miratohet dhe te formohet një grup punues dhe ne si komision të rregullojmë këtë projektligj.

Visar Ymeri – Tha se kur e kemi kthyer pas këtë projektligj, i kemi dhënë arsyet tona dhe tash jemi në situatë të njëjtë edhe një herë. Dhe, pasi që është i njëjti edhe në përmbajtje, normalisht që e kemi qëndrimin e njëjtë, që të mos e miratojmë.

Ramiz Kelmendi – Tha se nuk është miratuar ky projektligj dhe nuk ka qenë një lajmë i mirë për biznesin dhe për investitorët e huaj, andaj bëri thirrje të procedohet tutje dhe të miratohet sa më shpjet.

Teuta Sahatiqja – Tha se Qeveria është dashur të sillet me korrektësi dhe të ndryshojë së paku me ato vërejtje që janë dhënë, e jo të sillet i njëjti material, madje s' është ndryshuar as një pikë e asnjë presje. Dhe, normalisht që do votojmë kundër, tha në fund ajo.

Kryetari – Tha se puna jonë më e mirë, është që ta miratojmë dhe pastaj të punojmë në komision dhe ta bëjmë së bashku një ligj më të mirë.

Pas debatit, me pesë (5) vota për, katër (4) vota kundër, dhe një (1) votë abstenim, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr .04/L-180 për investimet e huaja.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-180 për investimet e huaja.

Grupi punues për shqyrtimin e këtij projektligji ka këtë përbërje: Myzejene Selmani, raportuese, Lutfi Zharku, Sala Berisha – Shala, Fikrim Damka, Ramiz Kelmendi dhe Visar Ymeri.

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit

Kryetari – Theksoi se po ashtu, sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë, duhet ta shqyrtojmë në parim këtë projektligj. Ai kërkoi nga deputetët të paraqesin vërejtjet e tyre në parim apo të rezervohen që t'i paraqesin në grupet punuese.

Pas debatit, Komisionit nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr .04/L-181 për produktet e ndërtimit.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit.

Grupi punues për shqyrtimin e këtij projektligji ka këtë përbërje: Hashim Deshishku, Zenun Pajaziti, Fikrim Damka, Lutfi Zharku dhe Ramiz Kelmendi.

7. Të ndryshme

Çështje vijuese

Sala Berisha - Shala - Kërkoi të tërhiqet nga kryesimi i grupit punues për Projektligjin Nr. 04/L158, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale, dhe të mbetet vetëm në cilësinë e anëtares së grupit punues, sepse siç tha ajo, ka punuar në fazat tjera, si në monitorim dhe hartim të këtij projektligji.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

V E N D I M

Deputeti Lutfi Zharku, caktohet raportues i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit Nr. 04/L-158, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale, në vend të deputetes Sala Berisha – Shala.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit